

REGJISTRIMI I BIZNESIT

Informata rreth procedurave për regjistrim të biznesit

- **LLOJET E BIZNESEVE**
- **REGJISTRIMI I BIZNESIT TË RI**
- **REGJISTRIMI I NDRYSHIMEVE NË BIZNES**
- **KËRKESA PËR SHUARJE TË BIZNESIT**

Një Shoqëri Tregtare mund të themelohet dhe regjistrohet në Kosovë për çfarëdo qëllimi të ligjshëm dhe mund të kryej çfarëdo veprimtarie të ligjshme të përcaktuar në nomenklaturen e kodeve të aktiviteteve. Kodet janë shifra që përputhen me aktivitetin / veprimtarinë e biznesit të cilin ju e kenipërzgjedhur për ta hapur.

Formularët që duhet të plotësohen për hapjen e biznesit përmbajnë edhe një pjesë ku kërkon që ta shkruani kodin (në anën e majtë) si dhe përshkrimin me fjalë (në anën e djathtë), të biznesit në fjalë. Listën për kodet mund ta gjeni në web faqen e ARBK-së www.arbk.org ose në faqen zyrtare të komunes tone <https://kk.rks-gov.net/lipjan/> Kodet janë katër shifrore.

Zyra për Regjistrimin e Bizneseve, bënë regjistrimin e të gjitha bizneseve të reja, ndryshimet e të dhënave të biznesit ,shuarjen e biznesit ,lëshimin e certifikatës për regjistrim me numrin fiskal, certifikaten e tatimit mbi vlerën e shtuar,certifikatën e export- importit , ofron informacionet si dhe formularët falas.

Në Zyren për Reegjistrimin e Bizneseve, regjistrohen këto lloje të bizneseve: Biznese Individuale, Ortakëri të përgjithshme, Shoqëri Komandite, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Shoqëri aksionare, Kompani të huaj, Ndërmarrje shoqërore, Ndërmarrje publike dhe Kooperativa bujqësore.

Duke qenë se këto lloje ndryshojnë në përgjegjësitë e tyre ligjore njëra nga tjetra, edhe dokumentet e kërkuara për regjistrimin e tyre fillestar, janë të ndryshme. Çdo aplikant, duhet të sigurohet për formën e biznesit që kërkon të regjistrojë përpara se të aplikojë për regjistrim fillestar.

• LLOJET E BIZNESEVE

Për lehtësinë e lexuesit, më poshtë në pika të shkurta janë spjeguar llojet e bizneseve:

1. Biznesi individual: Në biznesin individual, pronari ka përgjegjësi të pakufizuar për të gjitha borxhet e shoqërisë. Shoqëria ka një emërtim zyrtar ose përfshin mbiemrin e ligjshëm të pronarit dhe të përfshij shkurtesën "B.I."

2. Ortakëri e përgjithshme: Te ortakëria e përgjithshme, të gjithë ortakët përgjigjen pa kufizim, e solidarisht për borxhet e shoqërisë. Shoqëria kolektive ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve, duke vënë menjëherë pas tij shkurtesën "O.P."

3. Shoqëria komandite: Në shoqëritë komandite, përveç ortakëve "të pakufizuar" (ortakët që përgjigjen pa kufizim e solidarisht për borxhet e kompanisë) marrin pjesë edhe ortakët "e kufizuar" ose ata ortakë, që përgjigjen për detyrimet e kompanisë deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre. Shoqëria komandite ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve, duke vënë menjëherë pas tij, shkurtesën "SH.K.M."

4. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara (SH.P.K.): Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara janë ato shoqëri që janë themeluar nga një ose disa themelues, të cilët përgjigjen për të gjitha borxhet e tyre dhe detyrimet tjera me tërë asetet. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara ka një emërtim, menjëherë pas tij, shkurtesa "SH.P.K.". Zyra për Regjistrimin e Bizneseve mund të regjistrojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, pa pasur nevojë të siguroj dëshmi mbi pagimin e kapitalit.

5. Shoqëritë aksionare (SH.A): Shoqëri aksionare janë ato shoqëri, kapitali i të cilave ndahet në aksione dhe që aksionaret përgjigjen për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj. Shoqëria mund të themelohet e të ketë një ose disa aksionar. Ajo ka një emërtim, prapa të cilit vihet shkurtesa "SH.A.". Shuma e kapitalit fillestar të kësaj shoqërie është më së paku 10.000Euro.

6. Kompani e huaj: Kompania e huaj është shoqëri tregtare dhe prej momentit të regjistrimit konsiderohet si dega në Kosovë që nuk ka identitet të personit juridik. Pas regjistrimit i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e themeluara në bazë të ligjit të zbatueshëm. Pas emërimit shkruhet "DEGA NË KOSOVË".

7. Ndërmarrjet shoqërore: Ndërmarrje shoqërore do të thote një person juridik që shumica e asetëve dhe kapitali janë në pronësi shoqërore. Këto ndërmarrje deri në privatizim monitorohen dhe regjistrohen nga Agjencioni Kosovari i Privatizimit sipas Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqërite Tregtare.

8. Ndërmarrjet publike: Ndërmarrja Publike është ndërmarrje e cila kryen veprimtarine e interesit të përgjithshem, që është e themeluar nga shteti.Ndërmarrja publike monitorohet nga Qeveria dhe organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare. Të gjitha interesat pronësore në një ndermarrje publike do të përfaqësohen me aksione dhe të gjitha këto aksione duhet të jenë të regjistruara.

9. Kooperativat bujqësore: Kooperativa bujqësore është një shoqëri tregtare e krijuar nga personat fizikë apo juridik të cilët duhet të jenë të gjithë bujq që kontribuojnë me pronën e vet private në kapitalin aksionar. Kooperativa e Bujqëve themelohet nga së paku pesë (5) bujq, që janë nëshkrues të detyrimeve. Kooperativa nuk do të themelohet pa kapital e as nuk do të ekzistojë pa kapital. Kapitali ndahet në aksione të vlerës së barabartë me vlerë minimale prej 10 €. Drejtori nuk mund të jetë anëtar i kooperativës.Të gjitha këto mund ti shifni në Ligjin Nr.2003/9 për Kooperativat e Bujqëve si dhe Ligjin Nr,03/L-004 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kooperativat e Bujqëve Nr-2003/9.

• REGJISTRIMI I BIZNESIT TË RI

- **A. Çfarë duhet për regjistrimin fillestar?**
- **I. Formulari i aplikimit**
- Për të filluar një regjistrim, një aplikanti i duhet të plotësojë formularin e aplikimit. Përpara se të plotësohet formulari i aplikimit, aplikanti duhet të dijë informacionin e mëposhtëm:
- **1.** Formulari i aplikimit është specifik për lloje të ndryshme shoqërish tregtare që aplikojnë (persona fizikë që bëjnë biznes apo korporatë). Prandaj, aplikanti duhet të sigurohet që ai/ajo e di, nëse aplikimi do të jetë për një person fizik, i cili do regjistrohet për të kryer biznes apo për një korporate si dhe llojin e korporates. Informacioni mbi kërkesat ligjore të shoqërive tregtare mund të gjendet në ligjin Nr.02//L-123 për Shoqëritë Tregtare.
- **2.** Formularët e aplikimit mund të merren në dy mënyra:
- **a)** pranë zyres tonë; ose
- **b)** mund të shkarkohen nga faqja zyrtare e internetit të Komunes Tone
- Çdo zyrtar pranimi është i gatshëm të ndihmojë aplikantin të plotësojë të gjitha rubrikat e detyrueshme të formularit të aplikimit.

- **II. Dorëzimi i aplikimit për regjistrim në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve**
- **1.** Pasi formulari i aplikimit plotësohet, aplikanti(ose personi i autorizuar për regjistrim) paraqet formularin e aplikimit personalisht, në **Zyren për Regjistrimin e Bizneseve**, së bashku me dokumente të tjera shoqëruese, të duhura.
- **2.** Aplikanti ose personi i autorizuar, identifikohet tek zyrtari jonë nëpërmjet një dokumenti origjinal identifikimi, si dhe (për personin e autorizuar) nëpërmjet një autorizimi të nënshkruar, për përfaqësimin e aplikantit për qëllim regjistrimi.
- **3.** Zyrtari i pranimit verifikon që aplikimi dhe dokumentet shoqëruese janë të plota dhe të pranueshme. Nëse aplikimi është i paplotë ose i pasaktë, zyrtari i pranimit do të njoftoj dhe ndihmojë për shqarimin dhe plotësimin e formularit.
- **4.** Kur pranohet një formular aplikimi i plotësuar, duhet të jetë i nënshkruar nga aplikuesi apo përfaqësuesi i autorizuar.
- **5.** Taksa me rastin e regjistrimit të biznesit fillestar nuk paguhet, ndërsa për ndryshimet në biznesin ekzistues paguhet në bazë të Udhëzimit Administrativ të paraparë.

- **III. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e biznesit individual (B.I.)apo ortakëri e përgjithsme(O.P.):**
- **1.** Plotësimi i formularit B,
- **2.** Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë),
- **3.** Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 27.1 pika d) e Ligjit Nr. 02/L – 123,
- **4.** Për ortakëri të përgjithshme marrëveshjen e ortakëve të përgjithshëm në bazë të nenit 29 të Ligjit Nr. 02/L – 123.
- Afati për kryerjen e regjistrimit të biznesit individual dhe ortakërisë së përgjithshme në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve është 1 ditë.

- **IV. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërisë komandite(SH.K.M.) :**
- **1.** Plotësimi i formularit Ao,
- **2.** Marrëveshja e shoqërisë në bazë të Nenit 31.1 të Ligjit Nr. 02/L – 123,
- **3.** Statuti,
- **4.** Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve , përsoneve të autorizuar të përfshirë në biznes,
- **5.** Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 31.2 të Ligjit Nr. 02/L – 123.

- **V. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K):**

- 1. Plotësimi i formularit Ao,
- 2. Marrëveshja e shoqërisë në bazë të Nenit 86 të Ligjit Nr. 02/L – 123,
- 3. Statuti në bazë të nenit 33 të Ligjit Nr. 02/L – 123,
- 4. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve , përsoneve të autorizuar të përfshirë në biznes,
- 5. Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 33.2 të Ligjit Nr. 02/L – 123.
- Afati për kryerjen e regjistrimit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve është 3 ditë.

-

- **VI. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Shoqërive aksionare (SH.A):**

- 1. Plotësimi i formularit Ao,
- 2. Statuti në bazë të Nenit 35.1 të Ligjit Nr. 02/L – 123,
- 3. Marrëveshjen apo Rregulloren e Shoqërisë sipas Nenit 138 të Ligjit Nr. 02/L – 123,
- 4. Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 35.3 të Ligjit Nr. 02/L – 123,
- 5. Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të pronarëve , përsoneve të autorizuar të përfshirë në biznes.

-

- **VII. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Kompanisë së huaj-Dega në Kosovë:**

- 1. Plotësimi i formularit Ao,
- 2. Vendimi për hapjen e Kompanisë së huaj ,
- 3. Vendimin për emërimin e Drejtorit (pasaporta kopje) dhe Agjentit të regjistruar(letërnjoftimi kopje),
- 4. Vendimi nga gjykata e shtetit përkatës që biznesi ekziston(l noteruar,
- 5. Çertifikata e biznesit (origjinal apo kopje e noteruar, jo më e vjetër se tre muaj nga data e lëshimit dhe nëse nuk është në gjuhën shqipe, serbe apo angleze të përkthehet në njëren nga keto tri gjuhë dhe përkthimi të jetë i noteruar) që e hap perfaqësinë në Kosovë ,
- 6. Fotokopje e pasaportit të pronarit dhe drejtorit të Kompanisë së huaj ,
- 7. Fotokopje e statutit të kompanisë së huaj ,

- **8.** Pëlqimin e Agjentit të Regjistruar në bazë të nenit 23 të Të Ligjit Nr. 02/L – 123.
- **Verejtje:** Nëse pronari i biznesit nuk është prezent kur dorëzohen dokumentet atëherë aplikuesi mund ti dorëzoj dokumentet me autorizim dhe letërnjoftim kopje.
-
- **VIII. Lista e dokumenteve shoqëruese për regjistrimin e Kooperativës Bujqësore:**
- **1.** Plotësimi i formularit Ko,
- **2.** Marrëveshja e Shoqërisë,
- **3.** Statuti,
- **4.** Vendimi për emërimin e drejtorit,
- **5.** Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë) kopje të anëtarëve , personave të autorizuar të përfshirë në biznes,
- **6.** Pëlqimin e agjentit të regjistruar në bazë të nenit 23 të Të Ligjit Nr. 02/L – 123.

• **REGJISTRIMI I NDRYSHIMEVE NË BIZNES**

- Për të bërë ndryshime në biznesin tuaj ekzistues ju duhen këto dokumente si dhe t'i përdorni formularët përkatës, të mëposhtëm:
- Për çdo ndryshim që dëshironi të bëni në biznesin tuaj individual, ju duhet ta përdorin formularin B.
- **I. Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të emrit të Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme:**
- **1.** Plotësimi i formularit B,
- **2.** Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve),
- **3.** Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.
- **II. Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të adresës së Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme:**
- **1.** Plotësimi i formularit B,
- **2.** Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve),
- **3.** Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit.

- Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.
-
- **III.Dokumentet që janë të nevojshme për Ndryshim të tipit të Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme:**
 - **1.** Plotësimi i formularit B,
 - **2.** Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve),
 - **3.** Të dorëzohet certifikata e biznesit, origjinale,
 - **4.** Vërtetimi nga administrata tatimore për ndërrim të tipit të biznesit,
 - **5.** Marrëveshja në mes të ortakëve (nëse është ortakëri e përgjithshme).
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.
- **IV.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të numrit të punëtorëve në Biznes individual apo Ortakëri të përgjithshme:**
 - **1.** Plotësimi i formularit B,
 - **2.** Kopja e certifikatës së biznesit,
 - **3.** Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve).
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.
- **V.Dokumentet që janë të nevojshme për shtimin apo heqjen e veprimtarive në Biznes Individual apo Ortakëri të përgjithshme:**
 - **1.** Plotësimi i formularit B,
 - **2.** Kopja e certifikatës së biznesit ,
 - **3.** Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve).
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.
- **VI.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshimin e pronarëve në Biznes individual apo Ortakëri të përgjithshme:**
 - **1.** Plotësimi i formularit B,
 - **2.** Kopja e certifikatës së biznesit,

- **3.**Vërtetimi prej Administratës Tatimore të Kosovës , për ndërrim të pronarit,
- **4.**Kopja e letërnjoftimit të pronarit të kaluar dhe pronarit të ri,
- **5.**Marrëveshja në mes të pronarëve.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.

• **VII.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshimin e drejtorit apo agjentit në Biznesin Individual apo Ortakëri të përgjithshme:**

- **1.** Plotësimi i formularit B,
- **2.** Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve),
- **3.** Kopja e letërnjoftimit të drejtorit apo agjentit,
- **4.** Vendimi për ndërrim të drejtorit, kurse për ndërrim të agjentit duhet një deklaratë,
- **5.** Kopja e certifikatës së biznesit.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.

• **VIII.Dokumentet që janë të nevojshme për shtim apo heqje të njësisë në Biznesin Individual apo Ortakëri të përgjithshme:**

- **1.** Plotësimi i formularit B,
- **2.** Kopja e certifikatës së biznesit,
- **3.** Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve).
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.

• **I. Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të emrit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**

- **1.** Plotësimi i formularit A1 ,
- **2.** Aneks Statutin,
- **3.** Vendimin për ndryshim të statutit,
- **4.** Vendim për ndryshim të emërimit,
- **5.** Fotokopja e letërnjoftimit aksionarëve,

- **6.** Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit.
 - Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20€ të paguhet në bankë.
- **II.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të adresës të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**
 - **1.** Plotësimi i formularit A3,
 - **2.** Aneks Statuti,
 - **3.** Vendimi për ndryshim të statutit,
 - **4.** Të çeket edhe në vendim edhe në aneks statut, adresa e re,
 - **5.** Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit,
 - **6.** Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve.
 - Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20€ të paguhet në bankë.
- **III.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Tipit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**
 - **1.** Plotësimi i formularit A4,
 - **2.** Aneks Statuti,
 - **3.** Vendimi për të ndërrim të statutit,
 - **4.** Të dorëzohet certifikata e biznesit origjinale,
 - **5.** Statuti i ri,
 - **6.** Vërtetimi nga administrata tatimore për ndërrim të tipit të biznesit,
 - **7.** Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve.
 - Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € të paguhet në bankë.
- **IV.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të numrit të punëtorëve të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**

- 1. Plotësimi i formularit A5,
- 2. Aneks Statuti,
- 3. Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
- 4. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € të paguhet në bankë.

- **V.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Kapitalit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**
 - 1. Plotësimi i formularit A6,
 - 2. Aneks Statuti,
 - 3. Vendimi për ndryshim të kapitalit,
 - 4. Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
 - 5. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve.
 - Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € të paguhet në bankë.

- **VI.Dokumentet që janë të nevojshme për shtim apo heqje të Veprimtarive të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**
 - 1. Plotësimi i formularit A7,
 - 2. Aneks Statuti,
 - 3. Vendimi për ndryshim të statutit,
 - 4. Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
 - 5. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve.
 - Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € të paguhet në bankë.

- **VII.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Pronarëve-Aksionarëve të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**

- 1. Plotësimi i formularit A8,
- 2. Aneks Statuti,
- 3. Vendimi për ndryshim të statutit,
- 4. Kontrata mbi faljen ose shitjen e aksioneve,
- 5. Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
- 6. Fotokopja e letërnjoftimit, pasaportat, të aksionarëve.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20€ të paguhet në bankë.

- **VIII.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Drejtorëve apo të Agjentit të Regjistruar të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**

- 1. Plotësimi i formularit A9,
- 2. Aneks Statuti,
- 3. Vendimi për shkarkim dhe emërim të drejtorit /ëve apo të Agjentit të Regjistruar(deklaratën per Agjentin)
- 4. Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
- 5. Fotokopjet e letërnjoftimeve të drejtorit /ëve apo Agjentit të Regjistruar të shkarkuar dhe drejtorit /ëve të emëruar
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € të paguhet në bankë.

- **IX.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Njësive të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Shoqërisë komandite ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**

- 1. Plotësimi i formularit A10,
- 2. Aneks Statuti,
- 3. Vendimi për ndryshim të statutit,
- 4. Fotokopja e Certifikatës së biznesit,

- **5.** Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € të paguhet në bankë.

- **I.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Emrit të Kooperativës Bujqësore ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**
 1. Plotësimi i formularit K1,
 - **2.** Aneks Statutin,
 - **3.** Vendimin për ndryshim të statutit,
 - **4.** Vendim për ndryshim të emërimit,
 - **5.** Fotokopja e letërnjoftimit të anëtarëve,
 - **6.**Të dorëzohet Certifikata origjinale e biznesit.
 - Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € dhe të paguhet në bankë.

- **II.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të adresës të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**
 - **1.** Plotësimi i formularit K3,
 - **2.** Aneks Statuti,
 - **3.** Vendimi për ndryshim të statutit,
 - **4.** Të çeket edhe në vendim edhe në aneks statut, adresa e re,
 - **5.** Të dorëzohet certifikata origjinale e biznesit,
 - **6.** Fotokopja e letërnjoftimit të anëtarëve,
 - Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € dhe të paguhet në bankë.

- **III.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Kapitalit të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**
 - **1.** Plotësimi i formularit K6,
 - **2.** Aneks Statuti,
 - **3.** Vendimi për ndryshim të kapitalit,

- **4.** Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
- **5.** Fotokopja e letërnjoftimit të anëtarëve.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 euro dhe të paguhet në bankë.

- **IV. Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Veprimtarive të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**

- **1.** Plotësimi i formularit K7,
- **2.** Aneks Statuti,
- **3.** Vendimi për ndryshim të statutit,
- **4.** Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
- **5.** Fotokopja e letërnjoftimit të anëtarëve.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € dhe të paguhet në bankë.

- **V. Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Pronarëve-Aksionarëve të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**

- **1.** Plotësimi i formularit K8,
- **2.** Aneks Statuti,
- **3.** Vendimi për ndryshim të statutit,
- **4.** Kontrata mbi faljen ose shitjen e aksioneve,
- **5.** Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
- **6.** Fotokopja e letërnjoftimit të anëtarit (anëtarëve) – aksionarit (aksionarëve).
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € dhe të paguhet në bankë.

- **VI. Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Drejtorëve të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**

- **1.** Plotësimi i formularit K9,
- **2.** Aneks Statuti,
- **3.** Vendimi për shkarkim të drejtorit /ëve,
- **4.** Vendimi për emërim të drejtorit /ëve të rinj,

- **5.**Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
- **6.**Fotokopjet e letërnjoftimeve të drejtorit /ëve të kaluar dhe drejtorit /ëve të ri.
- Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € dhe të paguhet në bankë.

- **VII.Dokumentet që janë të nevojshme për ndryshim të Njësive të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:**
 - **1.**Plotësimi i formularit K10,
 - **2.**Aneks Statuti,
 - **3.**Vendimi për ndërrim të statutit,
 - **4.**Fotokopja e Certifikatës së biznesit,
 - **5.**Fotokopja e letërnjoftimit të anëtarit(anëtarëve).
 - Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 20 € dhe të paguhet në bankë.

• KËRKESA PËR SHUARJE TË BIZNESIT

I. Dokumentet që janë të nevojshme për shuarje të biznesit individual ose ortakërisë së përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit D
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve),
3. Çertifikata Origjinale e biznesit,
4. Vërtetimi prej Administratës Tatimore të Kosovës, për shuarjen e biznesit.

Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.

II. Dokumentet që janë të nevojshme për shuarjen e korporatave:

1. Plotësimi i formularit D
2. Shpallja në Gazetë Ditore të Likuidimit në njëren Gjuhë Zyrtare jo më të vogël se 1/10 e faqës
3. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për shuarje të biznesit
4. Vërtetimi nga Gjykata Ekonomike
5. Çertifikata origjinale e biznesit
6. Id-të kopje të pronarit ose pasaportat kopje , nëse është pronari i huaj

7. Vendimin për Likuidim i Korporatës

8. Vendimin për emrimin e Likuidatorit

9. Raporti mbi mjetet e kapitalit. Të trija këto bëhen në bazë të Ligjit Për Shoqërit Tregtare, Neni 229.

Fletëpagesa duhet të merret në Zyren për Regjistrimin e Bizneseve në shumë prej 10 euro dhe të paguhet në bankë.